

**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.**

Nr 143/3 Prot

Korçë, më 06.04.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Sipas Urdhërit të Zyrtarit të Autorizuar të AK , Nr. 143 prot, datë 15.02.2023 hartohen specifikimet me objektin e procedurës si me poshte vijon:

**Objekti i procedurës:** “Hipoklorit natriumi dhe bidona për klor”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Hipoklorit Natriumi 24312220-2

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

1.230.600 (një milion e dyqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

➤ **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 në vlerën 24 612 (njëzet e katër mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë) lek pa TVSH.*

c. *Listën e cmimeve të artikujve , sipas shtojcës 2*

d. *Formularin e Ofertës, sipas shtojcës 1*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

➤ **2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:**

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

**2.1.1** Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

## ➤ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet **2020, 2021** dhe **2022**, me një vlerë jo më të vogël se **30%** të vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Bazuar në nenin 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence". Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020, 2021** dhe **2022** të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit".

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, nenit 9, të Ligjit Nr.25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2022 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga

organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

*Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### ➤ 2.3 KAPACITETI TEKNIK DHE PROFESIONAL:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së së fondit të limit të përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit të kontratës ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetem fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruarat në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

**20% x 1.230.600 = 246.120 lek**

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 c) neni 55 pika 4, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

- **2.3.2** Ofertuesi duhet të vërtetojë që Hipokloriti i Natriumit që do të furnizohet është i përshtatshëm në trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor, konform normave europiane EN 901:2013 ose “ekuivalente”.

Për këtë qëllim duhet të paraqitet si dokument kualifikues, dokumentacion nga prodhuesi, që dëshmon që produkti i prodhuar plotëson standartin e kërkuar EN 901:2013. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Në përmbushje të kriterit të mësipërm, OE duhet të paraqesin dëshmi që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale për të krijuar bindjen se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara. Është në të drejten e AK të kërkojë dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, bazuar në **pikën 6/c, të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021** “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.3** Ofertuesi duhet të paraqesi çertifikatën e analizës nga **Instituti i Shëndetit Publik**, ose dëshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuara për lëshimin e tyre, për analizë toksikologjike për NaOCl. (hipoklorit natriumi) të marrë **brenda 3 muajve** të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. UKRK gjithashtu ka të drejtë të bëjë teste ose inspekte shtesë të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se hipokloriti i natriumit është konform specifikimeve dhe kushteve teknike të kërkuara. UKRK do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Blerësi UKRK do të refuzojë çdo sasi të hipokloritit të natriumit që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

**Argumentimi:** Kriteret e kualifikimit vendosen që ti shërbejnë AK-së, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE-ve, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme si aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe çdo element tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 40 pika 6/”c”.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera/huapërdorje 1 mjet të autorizuar për transport mallrash të rrezikshme sipas standartit të BE.

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Certifikate Pronesie , Leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme). Dhe për mjetet e mara me qera, kontraten perkatëse të Qerave/Huapërdorje të shoqëruar me Certifikate Pronesie leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme), për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet I pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

*Argumentimi:* Në ligjin nr.118/2012 “Per transportin e mallrave të rrezikshëm” Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi Nr.15, datë 24.7.2007 ”Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi në mënyrë periodike i një sasive të konsiderueshme mallrash specifike dhe me funksione speciale, automjeti i mësipërm konsiderohet i domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objektit në të cilin do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës. Furnizimi me kimikate do të kryhet me automjet të certifikuar për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. Automjeti për transportin e kimikateve duhet të jenë të përshtatshme për të mbajtur prodhim të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm. Ato nuk duhet të kenë transportuar më parë substanca të dëmshme ose të konsideruara si të tilla për ndotjen e ngarkesës së kimikatit

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, si dhe të gjitha shpenzimet e parashikuara në shtojcën 5 të specifikimeve teknike.

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërish çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë)*

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Cilësisë ISO 9001:2015 ose (ekuivalente/ e barazvlefshme me të) Çertifikata duhet të jete e vlefshme dhe të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, operatori ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas nenit 79 pika 1, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në nenin 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është vendosur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit. Çertifikatat duhet të lëshohen nga organet kompetente për të vërtetuar se mallrat i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duke mundur realizimin në kohë dhe me cilësi sipas standarteve të kërkuara.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Informacioni në lidhje me specifikat kryesore për Hipokloritin e Natriumit

Hipokloriti i Natriumit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme

PH < 8.0

Koha e nevojshme e kontaktit > 30 minuta

Turbullira <0.5 NTU

Specifikimet Teknike

Hipokloriti I natriumit ( NaOCl ), “ Cilësia e Ujit të Pijshëm “ nga VKM nr 379 datë 25.05.2016

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Objeti	Njesi	TOATAL SASI
1	Hipoklorit natriumi	kg	19.000
2	Bidona 25 litra për Hipoklorit Na	copë	50

❖ Hipokloriti I natriumit ( NaOCl ), “ Cilësia e Ujit të Pijshëm “ nga VKM nr 379 datë 25.05.2016

N r.	Parametrat	Njësia e matjes	Specifikat Kimike
1	Gjëndja	-	Lëng i kthjellët
2	Ngjyra	-	E Verdhë e çelët
3	Densiteti në 20°C	gr/ml	1.13 - 1.28
4	Titulli i Cl <sub>2</sub>	%	13- 15
5	Substanca Toksike	mg/kg	Limitet në mg/kg të klorit të lirë
6	Arsenik (As)	mg/kg	max 1
7	Kadmium (Cd)	mg/kg	max 2.5
8	Krom ( Cr)	mg/kg	max 2.5
9	Merkur (Hg)	mg/kg	max 2.5
10	Nikel (Ni)	mg/kg	max 2.5
11	Plumb (Pb)	mg/kg	max 15
12	Antimon (Sb)	mg/kg	max 20
13	Selen (Se)	mg/kg	max 20

### Specifikimet teknike për bidonat e hipokloritit te natriumit:

Enët mbajtëse duhet të jenë të përshtatshme për ruajtjen e hipokloritit të natriumit në gjëndje të lëngshme 13%-15%. Bidonat duhet të jenë të mbyllur me kapak si dhe në ngjyrë opake në mënyrë që të mbrojnë lëndën kimike nga drita e diellit.

### Grafiku i furnizimit, dhe oraret e dorëzimit të ngarkesave

Dërgimet e ngarkesave do të bëhen në bazë të një programi, për lenden Hipoklorit Natriumi 13-15% . Kërkesa për kimikate do të bëhet në sasi të dhe datat që do të jetë e nevojshme, kjo do të thotë se ka mundësi që sasi të mujore dhe datat e furnizimit me kimikatet e kërkuara të jetë pak te ndryshme krahasuar me grafikun e bashkëlidhur i cili është paraprak dhe orientues. Kjo lidhet me prodhimin e ujit dhe kushtet atmosferike.

Per Shoqerine Rajonale Ujesjelles Kanalizime Korce dorëzimi i ngarkeses se Hipoklorit Natriumi 13-15% do te behet ne depoziten e klorit prane Stacionit te Pompave Turan cdo muaj ne sasine prej 1375 kg (sasi totale prej 11.000 kg).

Per Shoqerine Rajonale Ujesjelles Kanalizime Njesia Devoll dorëzimi i ngarkeses se Hipoklorit Natriumi 13-15% do te behet prane stacionit te pompave te Ujesjellesit te Devollit cdo 2 muaj per sasine prej 1000 kg (sasi totale prej 4000 kg).

Per Shoqerine Rajonale Ujesjelles Kanalizime Njesia Maliq duke qene se nuk ka kapacitete mbajtese me depozita klorigjate dorëzimi i ngarkeses se Hipoklorit Natriumi 13-15% do te behet prane magazines se Njesise te Ujesjellesit Maliq i magazinuar ne bidona 25 kg (17 bidona 25 kg ) cdo muaj, pra 425 kg ne muaj (sasi totale prej 3400 kg). Bidonat do te jene nga sasia e parashikuar ne kete prokurim.

Per Shoqerine Rajonale Ujesjelles Kanalizime Njesia Pustec dorëzimi i ngarkeses se Hipoklorit Natriumi 13-15% do te behet prane stacionit te pompave te Njesise te Ujesjellesit Pustec ne fshatrat Gorice e Madhe, Gorice e Vogel dhe Zaroshke menjehere. Ne secilien depozite do te depozitohen 200 kg (sasi totale prej 600 kg).

Ne lidhje me njoftimet per furnizimet e ngarkesave Autoriteti Kontraktor do te njoftoje Operatorin Ekonomik te pakten 3 dite para. Furnizimi mund te kryhet nga dita e hene deri ditën e premtë nga ora 08:00 ne oren 16:00.

Depozitimi i 50 bidonave prej 25 kg secili do te behet prane magazines se Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Korce SH.A.

#### 1. Për shpenzimet

Të gjitha shpenzimet duke përfshirë ato të peshimit, të transportit dhe shkarkimit të kimikateve dhe bidonave në adresat e lartpërmendura sipas grafikut te levrimit, si dhe të analizave që do të bëhen përkatësisht për çdo ngarkesë dhe parti malli pranë Strukures Rajonale te Shendetit Publik Korce do të jenë në ngarkim të firmës fituese.

**Hartuar nga Struktura e Posacme pergjegjese per hartimin e specifikimeve sipas urdherit te Zyrtarit te Autorizuar te AK Nr143 Prot date 15.02.2023**

**Ornela Hysenlli      Ekonomiste**

**Sejla Tele              Inxhiniere Kimiste**